

ANALIZA VJETORE PËR VITIN 2018



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

DURRËS 2019



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR Durrës**

**ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
Durrës GJATË VITIT 2018**

Durrës 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR Durrës

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____.2019

ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS GJATË VITIT 2018

HYRJE

Materiali vijues përfaqëson në mënyrë të përmblodhur punën e kryer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit kalendarik 2018 dhe problematikat e hasura gjatë këtij viti sa i takon funksionimit të institucionit në tërësi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në strukturën e saj organike janë miratuar 17 gjyqtarë dhe në referim të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë, Nr. 1477, datë 24.02.2015, "Për miratimin e strukturave dhe organikën e gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit", për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, është miratuar një strukturë organizative respektivisht me 32 punonjës.

Gjatë periudhës Maj - Dhjetor 2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në veprimtarinë e sajë ka operuar me 15 Gjyqtarë, në mungesë të Gjyqtarës Ema Gashi, e cila ka qenë me leje shëndetësore 1 vjeçare sipas vendimit nr.33 dt.07.05.2018 Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për reflektimin e treguesve të punës, në këtë analizë të punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vitin 2018, është menduar të trajtohen treguesit që lidhen me performancën në menaxhim dhe në vendimmarrje, si dhe tregues që lidhen me tendencën e punës së gjykatës gjatë këtij viti.

Në funksion të një analize trajtuese dhe krahasuese me vitet e mëparshme, treguesit e punës janë evidentuar për çdo gjyqtar më vehte dhe për gjykatën në tërësi si trupë gjyqësore.

Gjithashtu, këtu do të bëhet krahasimi i ngarkesës së kësaj gjykate duke e krahasuar dhe me vitet e mëparshme. Në këtë përmbljedhje do të prezantohet dhe ngarkesa, shpejtësia dhe cilësia në aspektin e ecurisë së vendimeve në gjykatat më të larta për secilin gjyqtar.

Në këtë analizë do të mund të vlerësohet dhe trendi i ngarkesës dhe llojit të çështjeve në këtë gjykatë, pra cilat lloje të çështjeve janë rritur më shumë në vitin e fundit si dhe problematika të ndryshme që shtrohen për zgjidhje.

Po kështu, në material janë trajtuar shkurtimisht edhe aspekte që lidhen me infrastrukturën, teknologjinë dhe shërbimet administrative të ofruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, elementë këta që vlerësohen gjithashtu të kenë ndikim në performancën e gjykatës.

I. Infrastruktura

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës aktualisht vazhdon të jetë e vendosur në tre katet e para të godinës ekzistuese, e cila rezulton të jetë ndërtuar në vitin 1961, e cila është përshtatur për të kryer funksionin e Gjykatës.

Në vitin 1988 është ndërtuar kati i katërt i godinës e më pas, pas viteve 1990 është ndërtuar kati i pestë i saj, 2 kate këto në të cilat është vendosur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Rikonstruksioni i vetëm i godinës është kryer në vitin 1998 nga projekti PHARE dhe nga kjo datë çdo investim ka qenë për mirëmbajtjen e godinës, por në asnjë rast për rikonstruksion të saj.

Aktualisht gjendja e godinës përveç pamjaftueshmërisë së saj, paraqitet tejet e amortizuar dhe tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e detyrës nga ana e gjyqtarëve dhe administratës, si dhe për garantimin e transparencës, trajtimit dinjitoz e solemn të qytetarëve në kërkesat e tyre apo seancat gjyqësore.

Ambientet (veçanërisht ato të katit të parë) kanë lagështirë dhe muret janë të dëmtuara si në ambientet e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme të gjykatës.

Veç sa më sipër, godina ekzistuese paraqet problematikë edhe përsa i përket pozicionimit, hapësirave dhe planimetrisë së saj, të cilat bëjnë që kjo Gjykatë të jetë tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Kështu, pavarësisht se në Gjykatë ushtrojnë detyrën 17 Gjyqtarë dhe 32 punonjës, gjykata ka vetëm 4 salla gjykimi: nga një sallë në katin e parë dhe të dytë dhe dy salla në katin e tretë. Një nga këto salla përdoret ekskluzivisht vetëm për gjykime penale me të pandehur në gjendje arresti, për shkak të mungesës së sigurisë në sallat e tjera, ndërsa tre sallat e tjera përdoren nga të gjithë gjyqtarët sipas planifikimeve të kryera nëpërmjet kalendarit elektronik.

Pavarësisht se përdorimi i sallave të gjykimit rezulton të jetë maksimal, në shumicën e rasteve nga ora 08:30 – 16:00, është lehtësisht e kuptueshme që numri i sallave të gjykimit në raport me numrin e gjyqtarëve është jashtë çdo standardi dhe nuk plotëson as 50% të ngarkesës së çështjeve që gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë shkak ende numri më i madh i gjykimeve zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.

Gjithashtu, duhet theksuar se edhe sallat aktuale të gjykimi nuk ofrojnë nga madhësia, pikëpamja teknike dhe pozicionimi i tyre as zhvillimin në kushte normale të gjykimit dhe as nuk garantojnë sigurinë e gjyqtarëve.

Problematika e pamjaftueshmërisë së sallave të gjykimit është situatë emergjente, e cila reflektohet edhe në faktin se nga raportimi mujor nga ana jonë pranë Ministrisë së

Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi numrin e seancave që i nënshtrohen regjistrimit AUDIO (d.m.th. numrin e seancave gjyqësore të zhvilluara në sallat e gjykimit), rezulton se pavarësisht faktit se nga ana jonë përdorimi i sallave është thuajse maksimal, në total përqindja e seancave të zhvilluara në salla është rreth 44.5 %, pra shumë e ulët në raport me numrin e seancave gjyqësore të zhvilluara në zyrat e gjyqtarëve për shkak pamjaftueshmërie të ambienteve.

Po kështu, godina ekzistuese nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të administratës gjyqësore.

Pavarësisht hyrjes së ndarë që është krijuar për administratën dhe publikun, pas hyrjes të gjithë personat ndodhen në të njëjtin korridor dhe shkallët janë të përbashkëta, si për gjyqtarët, ashtu edhe për qytetarët.

Nga ana tjetër, dy nga sallat e gjykimit nuk kanë as dhomë këshillimi dhe gjyqtarët kur hyjnë dhe dalin në sallë ndodhen në të njëjtin ambient me qytetarët, çka nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë të gjyqtarëve.

Parkimi i pasëm i gjykatës ka kapacitet vetëm për 5-6 automjete, çka bën që gjyqtarët dhe administrata të parkojnë në ambiente të jashtme të gjykatës, në të cilat nuk mund të garantohet siguria.

Në lidhje me shërbimin e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi nga Komisariati i Policisë Durrës ofrohet asistencë me një punonjës policie në orarin 08:00 – 15:00, ndërkohë nga ora 15:00 – 08:00 të ditës pasardhëse shërbimi i sigurisë ofrohet nga një punonjës i shoqërive private, të cilët nuk kanë trajnimin e duhur profesional për të garantuar sigurinë specifike të gjykatës.

Kështu, si gjatë seancave gjyqësore edhe jashtë tyre gjyqtarët kanë një nivel sigurie më pak se minimal, jashtë standardeve europiane.

Sa i takon shërbimeve të ofruara qytetarëve nga ana jonë janë përshtatur 2 sportele ku ofrohen shërbimet e kryesekretarisë dhe shërbimet e tjera si: tërheqja e vërtetimeve, kopjeve të akteve apo vendimeve gjyqësore, etj. Ndërsa shërbimet e financës kryhen brenda gjykatës për shkak të pamundësisë fizike të ambienteve ku të përshtaten sportele.


Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Projektit të USAID-it "Drejtësi për të Gjithë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është shtuar pozicioni "Nëpunës Gjyqësor për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun". Kontrata e shërbimit është lidhur me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID dhe të gjitha pagesat janë kryer nga projekti.

Në shërbim të qytetarëve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka krijuar për herë të parë Zyrën e Informacionit në hyrje të institucionit dhe ofruar shërbime të ndryshme, e cila është administruar nga nënpunësi gjyqësor për marrëdhëniet me median dhe publikun mbështetur nga USAID. Mesatarisht në këtë zyrë ofrohen shërbime që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për 280 persona në javë.



Gjatë viti 2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka patur disa aktivitete dhe risi lidhur me veprimtarinë e gjykatës. Në bashkëpunim me zyrën e IT-së janë realizuar postera dhe video informuese të ndryshme. Kjo për mundësuar dhënien e informacionit tek qytetarët në forma të larmishme. Koncretisht janë realizuar postera dhe video informuese për:

a) Pajisjen me sistemin e video-konferencës në sallën e gjyqit, duke evidentuar dhe faktin se jemi gjykata e parë ndër gjykatat e rretheve në vendin tonë që e aplikojmë këtë sistem;



b) Njoftimin për zhvillimin e praktikës profesionale në gjykatë dhe plotësimin e vakancave në pozicionin sekretar gjyqësor në vitin 2019;

c) Mundësinë e aplikimit online të formularit për marrjen e dokumenteve nga arkiva e gjykatës, e cila përbën një risi për të gjitha gjykata e republikës së shqipërisë

Në sajë të këtyre videove, gjykata synon të orjentojë çdo person për të mundësuar marrjen e informacionit në kohë reale lidhur me çështjen e tij gjyqësore, të përfunduar ose në proces, pa qënë nevoja për tu paraqitur personalisht në ambientet e gjykatës.

Në faqen e web-it dhe në faqen zyrtare të gjykatës në facebook janë pasqyruar çdo ditë të rejtat më të fundit, si shorti ditor vakancat në administratën gjyqësore, mundësitë për praktikë, si dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me veprimtarinë e gjykatës, i rëndësishëm për publikun.



HAPAT PËR MARRJEN E REGJISTRIMIT AUDIO ONLINE



Regjistrimi audio në
postën tuaj elektronike...



Plasimi i formularit për të marrë
këtë të regjistruar në të drejtën
qytetare, në të drejtën penale
dhe në qytetarin e fëmijë
kërkuesin të gjykatës.



Në formularin online të regjistrimit
qytetar, në të drejtën penale
dhe në qytetarin e fëmijë
kërkuesin të gjykatës.



Në formularin online të regjistrimit
qytetar, në të drejtën penale
dhe në qytetarin e fëmijë
kërkuesin të gjykatës.

Regjistrimi audio në postën tuaj elektronike...



Pavarësisht synimit dhe vullnetit për të përshtatur ambiente normale pune për qytetarët, numri i sporteleve dhe vendosja e tyre janë në një ambient të ngushtë dhe të papërshtatshëm për ofrimin cilësor të shërbimeve të kërkuara.

Si rezultat i problematikave të mësipërme nga ana jonë është kërkuar në vijimësi investimi për ndërtimin e një godine të re, e cila të garantojë jo vetëm sigurinë për gjyqtarët dhe administratën, por të garantojë dhënien e drejtësisë sipas standardeve europiane, duke qenë e projektuar me numrin e nevojshme të sallave të gjyimit, ambiente të ndara për gjyqtarët dhe qytetarët, ambiente të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, etj., kërkesa këto të cilat i janë përcjellë si Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, ashtu edhe Ministrisë së Drejtësisë.

Ndërkohë, konsiderojmë si arritje faktin se projekti i ndërtimit të godinës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është miratuar në mbledhjen e datës 01.12.2015 me vendim të Këshillit Bashkiak Durrës, sipas planit të miratuar dhe aktualisht jemi në pritje të vijimit të procedurave përkatëse.



II. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimi AUDIO i seancave gjyqësore

Siç është parashtruar edhe në analizat vjetore të mëparshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, që nga viti 2007 e në vijim ka organizuar punën e saj duke u bazuar në sistemin e integruar të menaxhimit të çështjeve civile e penale CCMIS/ICMIS.

Pavarësisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme të këtij sistemi dhe zgjidhjeve të ofruara në vijimësi, vlen të theksohet se ende mbeten për zgjidhje disa çështje, ku ndër më kryesorët renditet ai i gjenerimit të të dhënave statistikore sipas modelit të kërkuar, në funksion të statistikave të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë.

Po kështu, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme dhe arritjes aktuale të funksionimit normal të portalit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës si një nga gjykatat që përdorin sistemin ICMIS (informacion i aksesueshëm në faqen zyrtare: (www.gjykata.gov.al), e cila administrohet nga Ministria e Drejtësisë, gjatë vitit 2018 janë hasur problematika të cilat mbeten t'u mbajtur në konsideratë dhe për t'u zgjidhur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Megjithëse nga ana e administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare, portali ka rezultuar që shpesh të mos jetë funksional, duke shkaktuar pamundësi të marrjes së informacionit nga ana e qytetarëve.

Në shumicën e rasteve portali ka ndërprerë së rifreksuari informacionin e dhënë nga gjykata jonë, duke mos shfaqur asnjë të dhënë në lidhje me regjistrimin, skedulet dhe shortin. Gjithashtu, edhe për çështjet e vjetra nuk është i aksesueshëm asnjë informacion.

Po kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka të pamundur të sistemojmë në mënyrën e duhur informacionin, pasi modifikimi i strukturës së faqes Web sipas nevojës dhe azhurnimi i të dhënave në këtë portal është i kufizuar, çka e bën të pamënaxhueshëm nga IT e gjykatës.

Problematikë aktuale edhe për vitin 2018 mbetet mungesa e një rregulloreje të unifikuar për të gjithë gjykatat që përdorin sistemin elektronik ICMIS, e cila do të ndihmonte në përcaktimin dhe detyrat e gjithsecilit përdorues të sistemit elektronik të çështjeve gjyqësore, duke bërë të mundur regjistrimin apo hedhjen e të gjithë informacioneve të nevojshme dhe të domosdoshme për gjenerimin e saktë të statistikave.

Ndërkohë nëpërmjet kërkesave të vazhdueshme nga ana e gjykatës, gjatë vitit 2018 është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë përshtatja e ICMIS sipas ndryshimeve e Kodit të Procedurës penale me ligjin nr.35/2017, për shtimit të regjistrave të rinj dhe të objekteve të kërkesave të ndryshme duke i kategorizuar sipas ndryshimeve ligjore, me qëllim përfshirjen e tyre në shortimit elektronik të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve.

Veçanërisht kjo nevojë ka lindur me hyrjen në fuqi edhe të ligjit nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" në janar 2018, pasi një pjesë e kategorive dhe informacionit të kërkuar për t'u ruajtur nga ky Kod, si dhe garantimi i anonimitetit të çështjeve me të mitur, nuk arrijnë të sigurohen nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve.

Po kështu, gjykimet e posaçme të cilat janë shtuar në numër dhe parashikojnë procedura të ndryshme të cilat duhet të reflektohen në ndryshime në sistem.

Sa i takon balancimit të ngarkesës së gjyqtarëve të Dhomës Civile mund të përmendet që përgjithësisht sistemi arrin të krijojë barazi ndërmjet seksioneve përkatës ku ata gjykojnë lidhur me numrin total të çështjeve të gjykuara.

Nga ana tjetër, një sukses i arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në sajë të projektit JUST ka qenë edhe implementimi i sistemit dixhital audio RDA në 4 sallat e gjyimit të gjykatës tonë qysh në shtator 2012 dhe vazhdon të jetë efektiv dhe funksional.

Ndërkohë, regjistrimi i seancave gjyqësore Audio është kthyer tashmë në një shprehje të zakonshme të gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim, duke pasur vlera të rëndësishme sa i takon rritjes së transparencës dhe solemnitetit të gjyimit.

Në serverin e gjykatës është instaluar GFI Backup Software. Ky Software shërben për të bërë backup Incremental regjistrimet Audio nga serveri lokal drejt Serverit qendror tek AKSHI, Tiranë. Për të punuar në mënyrë të rregullt sistemi monitorohet dhe për mirëmbahet nga stafi IT.

Bazuar në zhvillimet e fundit lidhur me sistemin Audio, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar shërbimin e Internetit, duke rritur shpejtësinë "Upload", në mënyrë që transferimi i të dhënave në serverin e qendror të AKSHI-t të jetë sa më i shpejtë dhe i sigurtë.

Sa i përket sigurisë së të dhënave të sistemit ICMIS dhe dokumentave të ndryshme elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nga ana e IT përveç se kryhet rregullisht çdo ditë backupi i këtyre të dhënave, përdoret gjithashtu dhe teknologjia "Cloud Storage and File Backup Online". Kjo hapësirë administrohet nga IT e gjykatës.

III. Kryesekretaria dhe sekretarët gjyqësorë

Kryesekretaria është sektori më i ngarkuar me punë administrative në këtë gjykatë dhe ka përgjegjësinë kryesore për shërbimet ndaj publikut. Megjithë përpjekjet maksimale konstatohet se numri i punonjësve që shërbejnë në Kryesekretari është i pamjaftueshëm. Kështu, puna voluminoze në Kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2018 është përballuar vetëm nga Kryesekretaria dhe një sekretare regjistruese, të cilat për të përballuar volumin e madh të punës janë detyruar të punojnë çdo ditë jashtë orarit.

Gjithashtu, numri i sekretarëve gjyqësorë nuk përballon ngarkesën dhe punën e gjykatës, pasi është numër tejet i vogël. Kjo ka bërë që në rast mungese të një sekretari për arsye të

ndryshme, të shkaktohen problematika lidhur me zhvillimin normal të punës nga ana e gjyqtarit përkatës, pasi në gjykatë nuk ka staf që të mundësojë zëvendësimin në rast mungesash.

Gjithsesi, pavarësisht problematikave të mësipërme, gjatë vitit 2018 e në vijim nga ana e Gjykatës janë përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme proceset e punës në Kryesekretari dhe sportelet e tjera, duke krijuar orare të posaçme për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, duke vendosur njoftime me sqarime të nevojshme lidhur me çështje të caktuara, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe etikën e personelit të gjykatës në komunikimin me qytetarët.

IV. Arkiva

Përsa i përket arkivave në këtë Gjykatë paraqitet një problematikë serioze që ka të bëjë me mungesën e hapësirave të mjaftueshme për të sistemuar arkivën e dosjeve penale dhe civile në një ambient të vetëm dhe të përshtatshëm. Në mungesë të hapësirave të përshtatshme, arkiva penale dhe civile është e shpërndarë në disa ambiente të ndryshme të gjykatës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka ambiente të mjaftueshme për vendosjen e dosjeve gjyqësore, të cilat datojnë nga viti 1949 dhe një pjesë e tyre madje janë vendosur në garazhet e gjykatës, pasi nuk ka asnjë ambient tjetër të përshtatshëm për këto dosje. Numri total i dosjeve të akivuara deri në vitin 2018 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është rreth 154623 dosje.

Për shkak të situatës së mësipërme ka filluar përpunimi i dokumentacionit nga viti më i hershëm për transferimin e dokumentacionit sipas anekseve të miratuara me urdhërin Nr.4895/4, datë 01.11.2016.

Gjatë vitit 2018 me urdhërin nr.61, datë 25.06.2018 të Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është urdhëruar transferimi i 64 dosjeve gjyqësore me afat ruajtje përgjithmonë, në një total 17.942 prej dosje, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

V. Dega e Buxhetit

Gjatë vitit 2018 ndër detyrat e tjera administrative dhe financiare kjo zyrë ka arkëtuar për interes të Shtetit të ardhurat në formën e taksave të padive dhe taksat mbi aktet dhe shërbimet gjyqësore të cilat në total arrijnë vlerën 19'421'518 Lekë të derdhura në Buxhetin e Shtetit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton të jetë mjaft efektive në vjeljen që në momentin e dorëzimit të kërkesë-padive dhe kërkesave të tjera të taksës gjyqësore dhe shpenzimeve të njoftimit.

Që nga 1 Janar 2015 dhe në vazhdim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është përfshirë në projektin e Gjykatave të cilat aplikojnë sistemin financiar elektronik Alpha WEB, i cili

duke qenë një program bashkohor mundëson të gjithë informacionin kontabël të nevojshëm dhe domosdoshëm sipas të gjitha kërkesave të legjislacionit në fuqi, gjithashtu në Mars 2018 Gjykatës i është miratuar një punonjës definitive në pozicionin e ekonomistit. Ky pozicion bën që struktura e financës të jetë më e plotë dhe ti përgjigjet në kohë dhe efektivitet të gjitha kërkesave dhe ndryshimeve në kohë.

Gjithsesi mbetet problematikë jo vetëm e gjykatës tonë mospasja e një mënyre matjeje të shpenzimeve gjyqësore sa i takon kostos të gjykimit, apo kostos së shlyrjes së seancës gjyqësore, e cila aktualisht barazohet vetëm me shpenzimet për njoftimet e palëve. Ndërkohë, në vendet e tjera një kosto e tillë përlllogaritet me koston e punës së paguar gjyqtarit dhe administratës gjyqësore, si dhe me matës të tjerë, të cilët janë të nevojshëm për analizën e kostos më pas. Mbetet për t'u parë në të ardhmen përgatitja dhe vënia në funksionim nga ana Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor e një mënyre për përlllogaritjen e kostove të mësipërme.

Nga kjo anë do të merren masa nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor që të saktësohet, formalizohet dhe unifikohet formati i llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore dhe kodifikimi i tyre sipas gjyqtarëve dhe të mundësohet shtimi i një opsioni në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ku të evidentohet vlera e objektit të padisë, tarifa gjyqësore dhe pagesa e saj, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i kësaj të ardhure.

Një problematike e vazhdueshme lidhur me buxhetin në këtë gjykatë ka qenë fondi shumë i vogël i akorduar kësaj gjykatë për shpenzimet e avokatëve kryesisht dhe të psikologëve nga njëra anë dhe për investimet nga ana tjetër.

Ndërkohë, duke pasur edhe Seksion Penal për të mitur, shpenzimet e gjykatës për psikologët dhe avokatët kryesisht, përkthyesit, ekspertët janë larta.

Duke qenë se Gjykata është treguar e kujdesshme në kontrollin, ndjekjen dhe pagesën e këtyre shpenzimeve, këto shpenzime janë afërsisht në të njëjtat nivele në krahasim me vitin 2017.

Po kështu, lidhur me këtë çështje mbetet problematike përcaktimi i tarifave për pagesën e avokatëve kryesisht, psikologëve dhe përkthyesve mbi bazën e seancave gjyqësore apo orëve të punës, përlllogaritje e cila do të ishte më e saktë, duke garantuar edhe një trajtim të barabartë të tyre në raport me shërbimin e ofruar.

Domosdoshmëri mbetet edhe ngritja e njësisë së prokurimit, e cila të ketë njohuritë dhe trajnimin e nevojshëm për të siguruar një ecuri normale të proceseve të prokurimit të shërbimeve dhe mallrave në institucion, njësi e cila për shkak të pamjaftueshmërisë së stafit administrativ është ngritur çdo vit në mënyrë të përkohshme, për realizimin e procedurave të tenderimit, por nuk është një strukturë e përhershme.

Pas kërkesave të vazhdueshme nga ana e Gjykatës, në Mars të vitit 2018 në strukturën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është miratuar 1(një) punonjës definitive në pozicionin e ekonomistit.

Organigrama e financës tani përbehet nga 2 punonjës. K/D/Buxhetit është punonjësi që kryen kontrollin e dokumentacionit dhe pranimin i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet dhe punonjësi i dyte ekonomisti, bën regjistrimet në kontabilitet të transaksionit financiar.

Shtimi i një punonjësi në strukturën e financës bën plotësimin e kësaj strukture si rezultat sjell raportimin në kohë për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë, garanton mbledhjen e të gjitha borxheve të pa arkëtuara, pagesën në kohë të të gjithë kreditorëve etj.

Si rezultat garanton zbatimin e Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ndryshuar me ligjin nr.110/2015.

VI. PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” taqen zyrtare është publikuar programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al> si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është një institucion që ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm në bashkëpunim me specialistin e IT-së përditësohet nga data e krijimit të saj referuar kërkesave të publikut të bazuara në Ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”,

Koordinatori për të drejtën e informimit përpunon të gjitha kërkesat, kthen përgjigje në rrugë elektronike dhe jep orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë që të marrin informacionin e nevojshëm me anë të fletëpalosjeve, formularëve apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare të gjykatës, ndërkohë urdhrat proceduralë apo akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të gjykatës.

Gjatë vitit 2018 janë trajtuar 9 kërkesa në përputhje me ligjin “Për të Drejtën e Informimit”.

Në vijim të sa mësipër, në funksion të analizës së punës për vitin 2018, treguesit e punës do të trajtohen në këto drejtime:

1. Volumi i çështjeve civile dhe penale për gjykim gjatë vitit 2018;
2. Cilësia e gjykimeve, bazuar në vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të larta, gjatë vitit 2018;
3. Shpejtësia në gjykim;
4. Marrëdhëniet me institucionet e tjera me të cilat lidhet puna e gjykatës.

I. VOLUMI I ÇËSHTJEVE

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë paraqitur gjithsej për gjykim 8426 çështje nga të cilat: 4524 (53.7 %) çështje themeli penale e civile; 3902 (46.3 %) kërkesa administrative penale e civile nga të cilat: 946 (24.2 %) kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe 827 (21.1 %) kërkesa gjatë fazës së hetimeve paraprake (Grafiku nr.1/Tabela nr.1).

Sipas Komisioni European për efencën në drejtësi (CEPEJ) për të analizuar e të dhënat statistikore në tërësi përdoren 2 indikatorë që janë Clearance Rate (CR indicator) i cili tregon raportin midis çështjeve të regjistruara me çështjet e përfunduara në përqindje dhe Disposition Time (DT) i cili tregon raportin e shpejtësisë së përfundimit të çështjeve gjyqësore të ardhura në gjykatë në ditë.

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se Clearance Rate për çështjet Penale (Treguesi Normale përfundimit/Likuidimit e çështjeve) gjatë vitit 2018 është 90.51 % dhe Clearance Rate për çështjet Civile është 95.7 %.

Koha e nevojshme për përfundimin e një çështje penale për vitin 2018 është 55 ditë dhe për çështjet civile është 76 ditë.

Clearance rate penal (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{penale2018} = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} \cdot 100 = \frac{2986}{3299} \cdot 100 = 90.51 \%$$

Clearance rate Civil (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$CR_{civile2018} = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} \cdot 100 = \frac{3740}{3908} \cdot 100 = 95.70\%$$

Case disposition time penale (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$DT_{penale} 2018 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2018}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{448}{2986} * 365 = 55$$

Case disposition time civile (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$DT_{civile} 2018 = \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2018}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 = \frac{782}{3740} * 365 = 76$$

Totali për secilin gjyqtar për vitin 2018

Nr.	Gjyqtari	Çështje të gjykuara	Çështje të caktuara	Numri i çështjeve deri me datë 31.12.2018	Clearance rate në %	Case disposition time në ditë
1	Joana Qeleshi	123	131	22	93.89313	65
2	Rexhep Bekteshi	580	641	75	90.48362	47
3	Dhurata Bilo	565	678	153	83.33333	98
4	Eda Kaja	627	679	106	92.34168	61
5	Fejzo Hysi	614	623	71	98.55538	42
6	Flora Hasimi	371	369	60	100.542	59
7	Markelian Koça	320	332	86	96.38554	98
8	Shpëtime Pitaku	479	519	95	92.29287	72
9	Shpëtim Reka	326	327	82	99.69419	91
10	Vladimir Skënderi	364	366	79	99.45355	79
11	Petraq Çuri	608	643	78	94.55677	46
12	Ema Gashi	47	24		195.8333	0
13	Besjana Garxenaj	315	326	74	96.62577	85
14	Paulin Çera	562	653	82	86.06432	53
15	Mimoza Margjeka	339	344	82	98.54651	88
16	Nurjeta Tafa	486	552	85	88.04348	63
	TOTALI	6726	7207	1230	93.32778	66

Grafiku nr. 1

Grafiku i ngarkesës për gjykatën në tërësi




Konstatohet se në numrin total të çështjeve për gjykim në vitin 2018 ka rritje të numrit të çështjeve nga viti 2017 nga 7976 në 8426.

Lidhur me numrin e çështjeve të themelit vërehet rritje gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017, në të cilin numri i çështjeve të themelit paraqitet 4524, kundrejt 4163 në vitin 2017. E shprehur në përqindje rritja e numrit të çështjeve të themelit paraqitet në 5 % më shumë se në vitin 2017. (Grafiku nr.2/Tabela nr.2).

Grafiku nr. 2

Nr. I çështjeve për gjykim themeli




Sa i takon numrit të çështjeve penale paraqitet rritje e ngarkesës me 10% nga viti 2017 në vitin 2018, duke rezultuar numri i çështjeve nga 2429 në vitin 2017 në 2993 në vitin 2018.

Rritja e ngarkesës të çështjeve penale lidhet me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë rritur rolin e gjykatës, konkretisht gjyqtari i seksionit penal shqyrton masat e sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër që i paraqitet gjatë fazës së hetimeve paraprake, kërkesat në seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjeve për gjykim, përkesa për pushimin e çështjeve apo miratimin e urdhërit penal.

Sa i përket çështjeve civile vërehet ulje nga 3733 në vitin 2018 në 4473 në vitin 2017, ose shprehur ndryshe 8.3% (Grafiku nr.3).

Në Dhomën Civile është riorganizuar puna e gjykatës me qëllim që secili seksion brenda kompetencave të tij të shqyrtojë çështjet që i takojnë sipas ligjit, konkretisht: Seksioni civil do të shqyrtojë çështjet civile, kërkesat civile dhe të gjithë urdhërat e ekzekutimit, seksioni familjar do të shqyrtojë të gjitha urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe çështje familjare, ndërsa seksioni tregtar do të shqyrtojë të gjitha çështjet tregtare.

Grafiku nr. 3
Grafiku krahasues për volumin e çështjeve të themelit.



Nëse do t'i referohemi numrit total të çështjeve të themelit të shqyrtuara gjatë vitit 2018 rezulton se nga 4524 çështje themeli, 955 (662 civile dhe 256 penale) janë mbartur nga vitit 2017 dhe 3569 (2696 civile dhe 973 penale) janë regjistruar gjatë vitit 2018. Nga këto çështje ka përfunduar gjykimi i 3374 ose 94 % prej tyre.

Ndërkohë, 1060 çështje janë mbyllur me vendim jopërfundimtar nga ana e gjykatës në raste të tilla si: kur është vendosur pushimi i çështjes për shkak të zgjidhjes së saj jashtëgjyqësisht, pushimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i padisë, pushimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit apo ankuesit, vendime pezullimi, pushim për shkak të tërheqjes së të dëmtuarit akuzues në rastin e veprave penale që gjykohen mbi ankimin e këtij të fundit, shpalljes së moskompetencës tokësore apo lëndore, etj.

Një pjesë e madhe e vendimeve jopërfundimtare sërish i takon seksionit civil, ku për shkak të paqartësive lidhur me kompetencën lëndore të një kategorie të çështjeve deri në vendimmarrjen e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga ana e gjyqtarëve është deklaruar moskompetenca lëndore, duke iu dërguar aktet gjykatës administrative dhe anasjelltas.

Lidhur me llojin e natyrës së çështjeve, nga të dhënat statistikore rezulton se në kategorinë e çështjeve civile gjatë vitit 2018 janë gjykuar 150 padi pronësie, 50 padi me objekt pjesëtim sendi, 504 padi me objekt zgjidhje martesë, 117 padi të rrjedhura nga marrëdhëniet e punës dhe 110 padi kundërshtim veprimesh përmbarimore.

Ndërkohë gjatë vitit 2018 janë paraqitur 2 kërkesë padi në procesin penal, ku për të dyja çështjet është vendosur veçimi i tyre nga procesi penal.

Ende ngarkesa më e madhe në Dhomën Civile i përket Seksionit Familjar, ku numri i padive me objekt zgjidhjen e martesës paraqitet më i lartë se çdo kategori tjetër të dhëna të cilat tregojnë se pjesa dërrmuese e padive të themelit janë ato që kanë si objekt zgjidhjen e martesës.

Në Seksionin Civil paditë gjatë fazës së ekzekutimit paraqesin numrin më të lartë të padive, ku objektet e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore apo pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë janë paditë kryesore të shqyrtuara gjatë vitit 2018.

Nga ana tjetër, sa i takon natyrës së çështjeve penale me ndryshimet me ligjin nr.35/2017 në K.Pr.Penale, është rritur numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime apo ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes për kundërvajtje penale. Në vitin 2018 janë paraqitur gjithsej për gjykim 1129 kërkesa të seancës paraprake, nga të cilat ka përfunduar gjykimi për 1071, ku për kërkesat penale për dërgimin e çështjeve për gjykim janë regjistruar 735 kërkesa dhe kanë përfunduar 700, për kërkesat penale për pushimin e çështjes janë regjistruar 359 kërkesa dhe kanë përfunduar 337 kërkesa. (Tabela Nr. 3/b)

Për çështjet penale themeli numri më i madh i tyre i takon veprës penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal me 36 të dënuar, neni 134/2 me 58 të dënuar, vepra Penale me Nen 130/a me 39 të dënuar, neni 199/a/1 me 65 të dënuar, neni 283/1 me 33 të dënuar, ndjekur nga çështjet kundravajtje neni 291 i Kodit Penal me 230 të dënuar. (Tabela Nr. 10)

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në Dhomën Penale funksionon Seksioni për të Mitur, i cili përbëhet nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur.

Gjyqtarët e Seksionit për të Mitur janë njëkohësisht dhe çështje për të rritur.

Në datën 1 janar 2018 kanë hyrë në fuqi Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë regjistruar 28 çështje penale ku të pandehur kanë qenë persona të mitur dhe kanë përfunduar gjatë këtij viti 31 çështje. Vlen për t'u përmendur se në caktimin e masave të dënimit në 61 % të rasteve është aplikuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në rastet e tjera janë aplikuar dënimet alternative sipas Kodit Penal. (Tabela nr.3/c)

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit të aplikuar nga gjykata në çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2018, referuar të dhënave të tabelës nr.9 konstatohet se lloji më i përhapur i dënimit është ai me burgim deri në 2 vjet (687 raste), ndjekur nga dënimi me gjobë (70 raste) dhe ai me burgim 2-5 vjet (55 raste).

Ndërkohë, gjatë vitit 2018 dënimet alternative rezultojnë të jenë aplikuar nga gjykata në 492 raste, ndër të cilat 425 është aplikuar neni 59 i Kodit Penal (pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim), në 65 raste gjykata ka vendosur punë me interes publik (neni 63 i Kodit Penal) dhe për dy raste është vendosur aplikimi i nenit 59/a (qëndrim në Shtëpi).(Tabela nr. 9)


Sa u takon masave të sigurimit gjatë fazës së hetimeve paraprake, masa e sigurimit “arrest në burg” është kërkuar nga organi i akuzës në 314 raste dhe është dhënë nga gjykata në 223, ose në 71% të rasteve. (Tabela nr.6/Grafiku Nr. 4)

Ndërkaq për rastet kur Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka kërkuar masën e sigurimit "Arrest me Burg", në 19 raste gjykata ka vendosur “arrest në burg me afat”; në 15 raste të tjera gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest në shtëpi”; në 6 raste “garanci pasurore” dhe në 48 raste “detyrim për paraqitje”. (Tabela Nr.7/Grafiku Nr. 5)


Nga ana tjetër, nga 73 kërkesa për zëvendësim të masës së sigurimit, nga gjykata janë pranuar 40 ose 54.8% e tyre. (Tabela Nr.8)

Grafiku nr.4

Grafiku i masave qe ka kerkuar prokuroria, në raport me gjykatën



Grafiku nr. 5



Vlen të theksohet se analiza matematike e treguesve të mësipërm do të çonte në një mesatarizim mekanik të punës të një gjyqtari gjatë vitit 2018, si referuar si ngarkesës së gjyqtarit, ashtu edhe natyrës së çështjeve të gjykuara nga ai, kjo si për shkak të ligjit material, ashtu edhe për shkak të ligjit procedural, ku rol të veçantë luan procesi i të provuarit.

Kështu, përgjithësisht gjykimi i çështjeve penale është më i shpejtë për shkak se së paku në mbi 88% të rasteve procedohet me gjykim të shkurtuar. Nga ana tjetër, edhe kërkesa administrative penale paraqesin lehtësi me të madhe se kërkesat civile si nga pikëpamja procedural, ashtu edhe nga pikëpamja e provueshmërisë.

Sa i përket gjytimeve të tjera të posaçme pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2018 janë paraqitur për gjykim 68 kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë.

Nëse i referohemi ngarkesës individuale për çdo gjyqtar konstatohet lehtësisht se numri më i madh i çështjeve të gjykuara vazhdon t'u përkasë edhe gjatë vitit 2018 gjyqtarëve të seksionit familjar, në një kohë që referuar edhe treguesve të tjerë të punës rezultoi se ngarkesa në numër e çështjeve nuk reflektohet në ngarkesë reale të këtij seksioni, përse kohë ngarkesa nuk mund të përcaktohet vetëm nga numri i çështjeve, por nga një sërë faktorësh.

Nga Janari 2018 e deri në Dhjetor 2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kanë ushtruar efektivisht detyrën, duke marrë pjesë edhe në short, gjithsej 15 gjyqtarë, të cilët në periudha të caktuara mund të kenë qenë të përjashtuar nga shorti për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore apo arsye pjesëmarrjeje në trajnime jashtë vendit.

Referuar të dhënave statistikore të detajuara në Tabelën nr.3 mund të bëhet një mesatarizim i punës së gjyqtarëve, sipas ndarjes së tyre në Dhoma e Seksione, natyrës së çështjeve, si dhe pjesëmarrjes në përbërje të trupave gjykues si anëtarë.


Konkretisht, për gjyqtarët e Dhomës Penale mesatarja e çështjeve për gjykim (penale, administrative penale dhe masa sigurimi) ka qenë 483 çështje; mesatarja e kërkesave të gjykuara në përbërje të trupave gjykues si anëtarë ka qenë 16 çështje për gjyqtar.

Sa i takon Dhomës Civile, për Seksionin Civil/Tregtar, mesatarja për gjyqtar ka qenë 335 çështje, ndërsa ajo e seksionit familjar 542 çështje. Mesatarja e kërkesave me objekt lëshim urdhëri ekzekutimi për gjyqtarët e Dhomës Civile në tërësi ka qenë 105 çështje për gjyqtar, ndërsa ajo e pjesëmarrjes në trupa gjykues ka qenë 13 çështje për gjyqtar.


Në tabelën Nr.3/a pasqyrohet numri i çështjeve për çdo gjyqtarë të deleguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë ku për vitin 2018 Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë deleguar për të gjykuar 73 çështje. Në vitin 2019 janë mbartur vetëm 10% të çështjeve.

Nga analizat e të dhënave vërehet rritje e ndjeshme e kërkesave të gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve krahasuar me vitet paraardhëse. Shkakët kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimmarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cënohet paanësia. Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi por më e paktë lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë. Gjatë vitit 2018 janë shqyrtuar nga Kryetarja e Gjykatës 194 kërkesa për heqje dorë, mesatarisht 12 kërkesa për gjyqtar nga të cilat 154 kërkesa janë miratuar dhe 40 kërkesa janë refuzuar. (Grafiku 3/a | Tabela 3/d).

Grafiku nr. 3/a
Kërkesa për heqje dorë ndër vite



Kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit janë paraqitur gjithsej 44, nga të cilat 35 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces civil dhe 9 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces penal. Për 5 kërkesa është vendosur pranimi duke përjashtuar gjyqtarin dhe për 39 është vendosur rrëzimi i tyre.



II. CILËSIA NË GJYKIM

Gjatë vitit 2018 Gjykata e Apelit Durrës ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur mbi ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për 925 vendime.

Nga këto vendime rezulton se për çështjet civile vendimet e gjykatës së shkallës së parë nuk janë cënuar në 69.8% të rasteve (69.8% vendime të lëna në fuqi). Ndërkohë, është vendosur ndryshimi i vendimeve në 13.2% të rasteve; është vendosur prishja dhe kthimi për rigjykim në 10% të rasteve dhe prishja dhe pushimi i çështjes në 10% të rasteve (Grafiku nr. 6/Tabela nr.4).

Grafiku nr. 6


Grafiku i cilësisë, bazuar në vendimet e gjykatës së apelit për çështjet civile



Ndërkohë më poshtë është paraqitur ecuria ndër vite e cilësisë për çështjet civile, referuar vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit.

Grafiku nr. 6/a

Grafiku i ecurisë së cilësisë ndër vite, bazuar në vendimet e gjykatës së apelit për çështjet civile.



Viti	Total LF (vlere)	(Vlera në %)	Cënuar (vlerë)	(Vlera në %)
2012	334	75.2%	110	24.8%
2013	358	73.36%	130	26.63%
2014	585	63.7%	304	33.1%
2015	469	73%	164	27%
2016	293	76%	90	24%
2017	275	68%	120	32%
2018	238	70%	103	30%


Grafiku nr. 7

Grafiku i cilësisë, bazuar në vendimet e gjykatës së apelit për çështjet penale.



Nga të dhënat e Grafikut nr.7 rezulton se sa i takon shqyrtimit të çështjeve penale në Gjykatën e Apelit, vendimet e gjykatës së shkallës së parë nuk janë cënuar në masën 67%, ndërkohë që janë ndryshuar vetëm në 4.6% të rasteve, janë prishur e kthyer për rigjykim në 3% të rasteve, janë prishur pushuar në 3.8% të rasteve, dhe janë cënuar vetëm pjesërisht në 19.5 % të rasteve. Ndërsa me mospranim ankimi janë shqyrtuar 37.5% e rasteve.

Grafiku nr. 7/a
Grafiku i ecurisë së cilësisë ndër vite, bazuar në vendimet e
Gjykatës së Apelit për çështjet penale.




Viti	Total LF (vlerë)	(Vlera në %)	Cënuar (vlerë)	(Vlera në %)
2011	207	82 %	45	18 %
2012	278	87.14%	41	12.86%
2013	171	84,23%	32	15,76%
2014	276	70,9%	113	29.1%
2015	302	77.4%	87	22.6%
2016	202	71.4%	81	28.6%
2017	268	73%	100	27%
2018	180	69%	81	31%

Lidhur me ndryshimet e vendimeve për caktimin e masave të sigurimit referuar arsytimit të vendimeve, ka rezultuar se gjykata e apelit një vëmendje të veçantë i ka kushtuar rrezikshmërisë shoqërore dhe përhapjes të veprave penale, e pasqyruar kjo dhe në sanksionin që ka parashikuar dispozita, si dhe rrezikshmërisë dhe personalitetit të personit të dyshuar se ka kryer veprën penale, në përputhje me nevojat e sigurimit, si dhe rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale për të cilën dyshohet i akuzuari.

Kështu 82 % e vendimeve nuk janë cënuar, 13 % janë ndryshuar dhe për 12 % të rasteve është vendosur Mospranim Ankimi. Theksojmë këtu se në pjesën më të madhe të rasteve të cënuara, është ndryshuar masa e sigurimit, nga arrest në burg në një masë tjetër më të lehtë (shiko Grafikon nr.8).

Në përqindjen e mësipërme ka ndikim edhe qëndrimi i ndryshëm i trupave gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës sa i përket lejimit të ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake për kalimin e çështjes në gjyq apo kthimin e akteve prokurorit, qëndrim i cili është konsoliduar më pas, duke mbështetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në qëndrimin që ndaj vendimeve të tilla nuk lejohet ankim.

Grafiku nr. 8
Grafiku i cilësisë për masat e sigurimit, sipas vendimarrjes së Gjykatës së Apelit.



Lidhur me shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, pjesa më e madhe e vendimeve rezulton të ketë kaluar me mospranim rekursi dhe lënie në fuqi.

Sa u takon vendimeve të cënuara përgjithësisht shkak ka qenë zbatimi i ligjit material dhe vetëm në një pjesë të vogël zbatimi i ligjit procedural.

Kështu, për çështjet penale rezulton se vetëm 1 çështje është ndryshuar, ndërkohë që në 98% të rasteve, vendimet e gjykatës së shkallës së parë nuk janë cënuar (shih Grafikon nr.9).

Gjithashtu, me qëllim evidentimin e ecurisë ndër vite dhe krahasimin e rezultateve, në Grafikon 9/a është paraqitur edhe ecuria e cilësisë ndër vite, referuar vendimarrjes së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku evidentohet rritja e cilësisë për vitin 2018 në këtë drejtim.

Sa u takon çështjeve civile, rezulton se në 16 të rasteve është vendosur mospranim i rekursit. (shih Grafikon nr. 10),

Gjithashtu, në Grafikon nr.10/a është paraqitur grafiku i ecurisë së cilësisë ndër vite, referuar vendimmarrjes së Kolegjeve Civile të Gjykatës së Lartë. Gjithsesi, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë nuk reflekton saktësi jo vetëm për shkak të shqyrtimit në kohë të çështjeve nga Gjykata e Lartë, por edhe për shkak të mosfunksionimit eficient të kësaj gjykate.


Grafiku nr. 9

Grafiku i cilësisë për çështjet penale, bazuar në vendimet e Gjykatës së Lartë.



rafiku nr. 9/a


Grafiku i ecurisë së cilësisë ndër vite për çështjet penale, bazuar në vendimet e Gjykatës së Lartë.



Viti	Total LF (vlere)	(Vlera në %)	Cënuar (vlerë)	(Vlera në %)
2014	2	28,5%	5	71,4%
2015	2	67%	1	33%
2016	4	80%	1	20%
2017	5	55%	4	45%
2018	2	66%	1	34%


Grafiku nr. 10

Grafiku i cilësisë, bazuar në vendimet e Gjykatës së Lartë për çështjet civile.



Grafiku nr. 10/a

Grafiku i ecuresisë së cilësisë ndër vite, bazuar në vendimet e Gjykatës së Lartë për çështjet civile.



Viti	Total LF (vlerë)	(Vlera në %)	Cënuar (vlerë)	(Vlera në %)
2014	1	20%	4	80%
2015	1	25%	3	75%
2016	7	63%	4	37%
2017	9	31%	20	69%
2018	3	42.8%	4	57.2%

III. SHPEJTËSIA NË GJYKIM

Përsa i përket shpejtësisë në gjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës paraqet tregues të kënaqshëm në funksion të dhënies së drejtësisë, brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas detyrimeve procedural dhe parashikimeve kushtetuese të nenit 42/2 dhe nenit 681 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Po lidhur me shpejtësinë në gjykim, kanë përfunduar deri në 2 muaj 77.3% e çështjeve penale, kanë përfunduar brenda periudhës 2-6 muaj 20.6 % e çështjeve, ndërkohë që në periudhat mbi 6 muaj-1 vit kanë përfunduar vetëm 3.1% (shih Grafikun nr.10/ Tabela nr.11).

Grafiku nr. 10

Grafiku bazuar në numrin e seancave: Penale




Ndërkaq, kanë përfunduar për periudhën deri në 2 muaj 55.9% e çështjeve civile, kanë përfunduar brenda periudhës 2-6 muaj 35.5% e çështjeve, ndërkohë që në periudhat mbi 6 muaj kanë përfunduar vetëm 8.6% e tyre (Shiko grafikun nr. 11/tabela 11).

Grafiku nr. 11
Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile



Grafiku nr. 12
Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile & Penale



Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit padiskutim më i rëndësishmi mbetet sistemi i adresave, i cili i lidhur me ndryshimet procedurale ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit.

Megjithatë, në shpejtësinë e gjykimit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, menaxhimi i çështjes për gjykim nga ana e vetë gjyqtarit, lloji i gjykimit (gjykimi i shkurtuar ose i drejtpërdrejtë në çështjet penale dhe ai i kërkesave civile), kompleksiteti i çështjes, realizimi i njoftimeve të rregullta të palëve e dëshmitarëve, përgjigjja e institucioneve publike e private, etj., faktorë ndër të cilët vend të veçantë zë edhe sjellja e palëve ndërgjyqëse gjatë gjykimit, çka rezulton ende të jetë shkaku kryesor për shtyrjen e seancave gjyqësore.

IV. MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE PUBLIKUN

Si një ndër institucionet kryesore me të cilat gjendet në marrëdhënie të vazhdueshme pune, marrëdhëniet me prokurorinë pranë kësaj gjykate kanë qenë në fokus të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të proceseve të punës dhe zgjidhjes së problematikave të hasura.

Veçanërisht rëndësi i është kushtuar dorëzimit të vendimeve brenda afatit ligjor, komunikimit të tyre palëve dhe dërgimit të dosjeve në gjykatën e apelit, problematikë kjo e mëparshme, e ngritur si shqetësim nga ana e prokurorisë.

Po kështu, është arritur zgjidhja e problematikave të ndërsjella nëpërmjet bashkëpunimit dhe përcjelljes së shqetësimeve ndër dy institucionet, çka ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të procesit të punës. Rëndësi e veçantë i është kushtuar vendosjes së praktikave në lidhje me zbatimin sa më korrekt dhe efektiv të ndryshimeve procedurale.

Sjellja e prokurorëve reflektohet përgjithësisht korrekte, duke u evidentuar raste jo të shpeshta të mospjesëmarrjes në gjykim pa njoftuar paraprakisht gjykatën, apo paraqitjes me vonesë në fillimin e seancës gjyqësore. Megjithatë, vlen të theksohet se përgjithësisht problematikat e ngritura respektivisht nga të dy institucionet kanë gjetur përgjigje.

Sa i takon marrëdhënieve me Dhomën e Avokatisë Durrës, përgjithësisht nga ana e avokatëve është reflektuar sjellje korrekte përsa i përket solemnitetit dhe orarit të gjykimeve. Në raste të veçanta gjyqtarët kanë njoftuar Dhomën e Avokatisë për marrjen e masave ndaj avokatëve konkretë. Problem mbetet shlyerja e pagimit të gjobave nga ana e avokatëve, në rastet e caktuara nga gjykata.

Nga ana tjetër, në kuptim të nenit 49/3 të Kodit të Proedurës Penale, Dhoma e Avokatisë Durrës ka paraqitur rregullisht listën e avokatëve të gatshëm për t'u caktuar kryesisht, e cila përgjithësisht respektohet nga gjyqtarët në varësi të ngutshmërisë së çështjes dhe gadishmërisë së avokatëve të listuar.

Në funksion të përmirësimit të shërbimit të ofruar nga ana e gjykatës për avokatët është caktuar një orar i veçantë për kryerjen e veprimeve pranë kryesekretarisë, i cili funksionon në mënyrë optimale.

Mbetet ende për t'u zgjidhur kërkesa e vazhdueshme e Dhomës së Avokatisë Durrës për sigurimin e një ambienti të veçantë për avokatët, i cili pavarësisht vullnetit tonë pozitiv nuk

është bërë ende i mundur të sigurohet për shkak të pamjaftueshmërisë së ambienteve të godinës.

Lidhur me marrëdhëniet me publikun, në mënyrë të veçantë i është kushtuar rëndësi transparencës edhe në drejtim të bërjes publike, nëpërmjet afishimit, edhe elektronikisht, në hapësirën e pritjes së palëve ndërgjyqëse ku shpallen edhe listat e gjykimeve, të listës së çështjeve të hedhura në short, urdhërave të ndryshme lidhur me orarin dhe shërbimet e ofruara nga administrata gjyqësore etj. Mjaft efektive ka rezultuar komunikimi me publikun nëpërmjet faqes elektronike zyrtare dhe rrjeteve sociale si Facebook, kanalit të dedikuar në Youtube, etj.

Gjithashtu, i është kushtuar rëndësi aksesit të të interesuarve në dokumentacionin dhe aktet e gjendura në gjykate.

Po kështu, ambienti i veprimeve gjyqësore është përmirësuar, duke krijuar kushte të përshtatshme, orare specifike dhe sportele të veçanta për veprime të caktuara, me qëllim shmangien e vonësive të panevojshme. Në mënyrë të veçantë përmendet këtu urdhërimi i kryesekretarisë dhe arkivës për të garantuar çdo informacion apo shërbim maksimalisht brenda 24 orëve.

Nga ana e gjykatës janë zhvilluar takime sensibilizuese me grupe të ndryshme si nxënës shkollash, studentë, qytetarë, etj., në kuadër të aktiviteteve në ditë të caktuara, si dhe në kuadër të afrimit sa më shumë me gjykatën të qytetarëve dhe sistemin e drejtësisë.

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuara dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2018 do t'i shërbejnë si trupës gjyqësore, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me sistemin gjyqësor, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të trupës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj gjykate.

TABELA E NGARKESES PËR GJYKATËN NË TËRËSI (Tabela 1)

Numri i çështjeve për gjykim (themeli)		Çështje të mbartura nga viti 2017		Çështje të regjistruara në vitin 2018 (Themeli)		Çështje të Përfunduara		Urdhra ekzekutimi	Kërkesa (të regjistruara)		Çështje të mbaruara duke u zgjidhur jo në themel		Çështje të mbartura për vitin 2019		Kërkesa penale gjate fazës së hetimeve paraprake
Civ.	Pen.	Civ.	Pen.	Civ.	Pen.	Civ.	Pen.		Civ.	Pen.	Civ.	Pen.	Civ.	Pen.	
3395	1129	699	256	2696	873	2522	852	946	1192	2710	1034	26	763	467	827
4524		955		3569		3374		946	3902		1060		1230		827

VITI	Numri i çështjeve mbartura për gjykim (themeli)		Çështje të mbartura nga viti paraardhës		Çështje të regjistruara në atë vit		Urdhëra Ekzekutimit		Çështje të Përfunduara		Çështje të mbaruara duke u zgjidhur jo në themel		Çështje të mbartura për vitin në vijim		Kërkesa penale gjate fazës së hetimeve paraprake
	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	
2013	3490	921	859	127	2631	794	1903		3002	701	934		610	241	1013
Totali	4411		986		3425		1903		3703		934		851		1013
2014	2642	1332	610	241	2032	1091	1974		1993	1120	939		711	215	1293
Totali	3974		851		3123		1974		3113		939		926		1293
2015	3691	1547	711	215	2980	1332	1851		2113	1301	1079		776	281	1225
Totali	5238		926		4312		1851		3414		1079		1057		1225
2016	2789	1298	776	281	1986	1072	1977		2070	1111	837		804	258	1067
Totali	4087		1057		3058		1977		3181		837		1062		1067
2017	3150	1013	906	181	2224	832	1590		2631	820	1349		699	256	891
Totali	4163		1087		3076		1590		3451		1349		955		891
2018	3395	1129	699	256	2696	873	946		2522	852	1060		763	467	873
Totali	4524		955		3569		946		3374		1060		1230		873

Gjyqtari	Përfunduar										Të mbartura për në vitin 2019		Pjesëmarrje në gjyqime si anëtar		Totali	
	Civ. Total	Pen. Total	Urdhëra ekzekutimi	Kërkesa Adm. Civile	Kërkesa Adm. Penale	Seanca Paraprake	Vendime Jo përfundimtare Civile	Vendime Jo përfundimtare Penale	Masa Sig.	Civ.	Pen.	Civ.	Pen.	Përf. Kryes	Përf. Anët	
Joana Qeleshi	9	114		1	14	13	2	3	3	5	16	1	19	123	20	
Rexhep Bekteshi		580			123	239			106		75		22	580	22	
Dhurata Bilo	564	1	103	30			197		3	153		18	2	565	20	
Eda Kaja	17	610		4	128	231	6	4	123	2	104		10	627	10	
Fejzo Hysi	592	22	99	26	9		173	1	15	71		20	7	614	27	
Flora Hasimi	371		107	37			59			60		2	1	371	3	
Markelian Koça	320		103	33			56			86		3		320	3	
Shpetime Pitaku	472	7	103	28	8		113		4	95		26	4	479	30	
Shpetim Reka	326		99	26	1		72			82		2	1	326	3	
Vladimir Skënderi	353	11	121	24	2		5		8	79		2	1	364	3	
Mimoza Margjeka	330	9	105	28			55		9	82		3	1	339	4	
Petra Çuri	20	588		3	117	209	10	6	102	6	72		12	608	12	
Ema Gashi	7	40		3	20	9	2						3	47	3	
Nurjeta Tafa	29	457		2	71	172	5	8	77	10	75	1	16	486	17	
Paulin Çera	9	553		1	85	198	5	4	117	5	77		17	562	17	
Besjana Garxenaj	314	1	106	21						74		4		315	4	
Totali	3733	2993	946	267	578	1071	760	26	567	57	1230	82	116	6726	198	

Tabela për gjyqtarët e deleguar për të gjykuar çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për 2018.
(TABALA 3/a)

Nr.	Emri i Gjyqtarit	Çështje të deleguara për gjykim gjatë vitit 2018	Gjykata në të cilën është deleguar
1.	Joana Qeleshi		
2.	Rexhep Bekteshi	11	Kavajë
3.	Paulin Çera	14	Kavajë
4.	Eda Kaja	11	Kavajë
5.	Petraq Çuri	11	Kavajë
6.	Nurjeta Tafa	11	Kavajë
7.	Shpëtim Reka	2	Kavajë
8.	Mimoza Margjeka	2	Kavajë
9.	Vladimir Skënderi	-	-
10.	Besjana Garxenaj	2	Kavajë
11.	Markelian Koça	-	-
12.	Flora Hasimi	2	Kavajë
13.	Shpëtime Pitaku	-	-
14.	Dhurata Bilo	-	-
15.	Fejzo Hysi	1	Kavajë
16.	Ema Gashi	6	Kavajë
Totali		73 Çështje	

Çështje penale me të pandehur të mitur Viti 2018

Të regjistruara		Të përfunduara
28 çështje		31 çështje

Masat e sigurimit për të miturit Viti 2018

	Arrest me Burg	Detyrim paraqitje	Arrest Shtëpie
Numri i rasteve	7	7	1

Masa e dënimit për të miturit Viti 2018

Mjekim i detyruar ambulator	Aplikuar neni 63 i Kodit Penal	Aplikuar neni 59 i Kodit Penal	Aplikuar neni 59 i Kodit Penal + 104 KDPM	Përfshirja nga dënimi (Neni 52 i Kodit Penal)	Neni 101/2 dhe 109 i KDPM	Neni 96/c + 103 KDPM	Neni 104 KDPM + neni 60 KP	Burg deri në 1 vit	Burg mbi 1 vit
Të mitur	1	9	4	9	1	1	7	4	1

Akuza për të miturit Viti 2018

	Neni 134/2	Neni 139 e 25 i KP	Neni 291	Neni 300	Neni 278/3	Neni 79/a
Të mitur	26	2	8	1	1	1

Të mitur viktimë nga veprat penale Janar 2018 - Shtator 2018

	Neni 130/a	Neni 273	Neni 130/a/4	Neni 108/1
Të mitur	1	1	1	2

KËRKESA PËR HEQJE DORË VITI 2018

Tabela nr.3/d

Nr. Rendor	Emri i Gjyqtarit	Numri i kërkesave për heqje dorë		
		Miratuar	Refuzuar	Totali
1.	Joana Qelesi	2		2
2.	Rexhep Bekteshi	14	12	26
3.	Paulin Çera	13	3	16
4.	Eda Kaja	3	2	5
5.	Petraç Çuri	12		12
6.	Nurjeta Tafa	14	3	17
7.	Shpëtim Reka	7	1	8
8.	Mimoza Margjeka	3	4	7
9.	Vladimir Skënderi	14	1	15
10.	Besjana Garxenaj	6	1	7
11.	Markelian Koça	27	5	32
12.	Flora Hasimi	15	4	19
13.	Shpëtime Pitaku	18	3	21
14.	Dhurata Bilo	3		3
15.	Fejzo Hysi	4	1	5
16.	Ema Gashi	1		1
Totali:		156	40	196

TABELA E CILËSISË, BAZUAR NË VENDIMET E GJYKATAVE MË TË LARTA (TABELA 4)
Çështjet Civile të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vitin 2018

GJYQTARI	GJYKATA E APELIT							GJYKATA E LARTË							Totali	
	Lënie në fuqi	Mosp rankimi	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	Ndryshuar	Prishur vazhdim gjykimi	L.F cënim	Lenie ne fuqi	L.F Cënim	Prishur /Pushuar	Prishur kthyer	Mospranim rekursi	Vazhdim gjykimi	L.F	L.F cënim	
J.Qeleshi	2											1		2	0	
R. Bekteshi				1						1				0	0	
Dh. Bilo	12	3		4	7		1					2		12	1	
F. Hysi	10	2			4		3							10	3	
F. Hasimi	31		1	3	9		5			1				31	5	
N. Gjura														0	0	
E. Kaja	3	1	1		1							1		3	0	
M. Koça	22	1		1	1		1	1				1		23	1	
Sh. Pitaku	20	1		1	4		2							20	2	
Sh. Reka	19			3	4					1		4		19	0	
K.Selita														0	0	
A.Mici														0	0	
V.Skënderi	35	3	5	9	8		1	1				1		36	1	
P.Çuri	7		1	3	1		2					2		7	2	
A.Brati	4			1	1							3		4	0	
M.Margjeka	13	2		2	1		1	1			1			14	1	
E.Gashi	23			3	2									23	0	
P.Çera	2			1										2	0	
N.Tafa	17													17	0	
B.Garxenaj	18			2	2									18	0	
TOTALI	238	13	8	34	45	0	16	3	0	3	1	16	0	241	16	

Shënim: Në këtë tabelë janë shënuar përveç çështjeve civile të përgjithshme, çështjet civile të veçanta, si dhe vendimet e ndërmjetme. Tek tabela e çështjeve “Prishur/Pushuar” janë shënuar edhe ato çështje të cilat janë pushuar për shkak të heqjes dorë prej ankimit nga palët.

TABELA E CILËSISË, BAZUAR NË VENDIMET E GJYKATAVE MË TË LARTA (TABELA 4)

Çështjet civile të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë

VITI	GJYKATA E APELIT						GJYKATA E LARTË								
	Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	L.F (cënim)	Totali		Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	Mospranim rekursi	L.F (Cënim)	Totali	
						L.F	CN							L.F	CN
2011	343	39	13	22		343	74	5	1		2	44	1	49	4
2012	334	56	25	29		334	110	12	2	1	7	53		65	10
2013	215	33	65	19		215	117	1		1		106		107	1
2014	585	124	59	121		585	304	1		3	1	45		1	4
2015	469	62	41	53	8	469	164	1	1	1	1	77		1	3
2016	293	25	21	39	5	293	90	7		2	2	96		7	4
2017	275	26	38	43	13	275	120	9		19	1	76		9	20
2018	238	45	8	34	16	238	103	3		3	1	16		3	4

TABELA E CILËSISË, BAZUAR NË VENDIMET E GJYKATAVE MË TË LARTA (TABELA 4)

Çështjet penale të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vitin 2017

GJYQTARI	GJYKATA E APELIT					GJYKATA E LARTË							Totali	
	Lëni e në fuqi	Mosp ranki mi	Prishur, pushuar	Prishur , kthyer	Ndryshuar	Prishur vazhdim gjykimi	L.F cënim	Lenie ne fuqi	L.F Cënim	Prishur pushuar	Prishur kthyer	Mospranim rekursi	Ndryshuar	L.F L.F cënim
J.Qelesi	12	10	2				2							12
M.Margjeka														0
R.Bekteshi	37	27	3				7					1	1	37
E.Gashi	1				1		1	0	1					1
F. Hysi	6	1		1										1
E. Kaja	26	17	1	4	5		6					1		26
Sh. Pitaku	2	2					1							2
A.Mici	2						1							2
V.Skenderi	1													1
P.Çuri	27	19	1	2	4		18							27
T.Hamitaj	1	2	1				2							1
N.Tafa	20	4	2				4							20
P. Çera	45	20		1	2		9							45
TOTALI	180	98	10	8	12	0	51	0	1	0	0	2	1	180
														52

Shënim: Tek tabela e çështjeve “Prishur/Pushuar” janë shënuar çështje të cilat janë pushuar për shkak të heqjes dorë prej ankimit nga palët dhe për çështjet e pushuar për amnisti.

Në këtë tabelë janë shunuar dhe çështjet e veçanta penale.

TABELA E CILËSISË, BAZUAR NË VENDIMET E GJYKATAVE MË TË LARTA (TABELA 7)

Çështjet penale të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë

VITI	GJYKATA E APELIT						GJYKATA E LARTË								
	Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	L.F (çënim)	Totali		Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	Mospranim rekursi	L.F (Çënim)	Totali	
						L.F	CN							L.F	CN
2011	164	17	17	11	39	207	45	1		2	2	35		36	4
2012	181	14	17	10	61	278	41	5		2		91	3	96	5
2013	172	25	60	11	32	204	86	1				106		107	
2014	276	26	62	25	16	273	113	2	1	2	2	139	39	2	5
2015	302	28	16	12	21	302	87	2	1			181		2	1
2016	202	53	14	9	5	202	81	4	1			124		4	1
2017	194	26	61	13	74	268	100	5	2	1	1	77		5	4
2018	180	12	10	8	51	180	81		1			2		2	1

Kërkesat paraprake (Masa Sigurimi) gjatë fazës së hetimit të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vitin 2018

GJYQTARI	GJYKATA E APELIT						GJYKATA E LARTË						Totali		
	Lënie në fuqi	Mosp ranki mi	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	Ndryshuar	Prishur vazhdim gjykimi	L.F cënim	Lenie ne fuqi	L.F Cënim	Prishur pushuar	Prishur kthyer	Mospranim rekursi	Ndryshuar	L.F	L.F cënim
J.Qeleshi														0	0
R. Bekteshi	13	2			4							3		13	0
E.Gashi														0	0
F. Hysi		1										2		0	0
E.Kaja	12	3			1		2					2		12	2
P.Çera	12				2							3		12	0
Sh. Pitaku												1		0	0
M.Margjeka	1													1	0
P.Çuri	13	2	1		2									13	0
N.Tafa	9	1			1									9	0
TOTALI	60	9	1	0	10	0	2	0	0	0	0	10	0	60	2

TABELA EAZUAR NË VENDIMET E GJYKATA...

Masat e Sigurimit të kthyer nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë

VITI	GJYKATA E APELIT						GJYKATA E LARTË								
	Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	L.F (cënim)	Totali		Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur, pushuar	Prishur, kthyer	Mospranim rekursi	L.F (Cënim)	Totali	
						L.F	CN							L.F	CN
2010	108	9	1		30	108	40	1				48	1	49	1
2011	110	10	1		18	110	29	1			1	26		27	1
2012	134	19	4	9	10	134	42	5		4	1	61		66	5
2013	117	5	4		6	117	15					10		10	
2014	207	13	4	1	19	207	18					30	2		
2015	238	2	7		19	238	28	2				53		2	
2016	118	14				118	14					21			
2017	65	11			7	65	11				1	21			1
2018	60	10	1		2	60	13					10			

KËRKESA GJATË FAZES SË HETIMEVE PARAPRAKE (TABELA 5)

LLOJI KËRKESËS	NR. RASTEVE
Vlefshëm arrestimi dhe caktim mase	299
Vlefshëm ndalimi dhe caktim mase	14
Caktim mase sigurimi	50
Vlefshëm arrestimi dhe gjykim i drejtpërdrejtë	68
Zëvendësim mase sigurimi /Revokim mase sigurimi	73
Marrje në pyetje lidhur me kushtet e arrestimit si masë sigurimi	50
Deklarim i keq	14
Lejtim+vlefshëm përgjimi+ kontroll banese	201
Caktim mase për qëllim ekstradimi + ekstradim	2
Shuarje mase	11
Vendosje sekuestro	14
Informacion + Rivlerësim + Zhbllokim Garancie	11
Vlefshëm arrestimi ne flagrante dhe ndalimi pa caktur masë sigurimi	1
TE TJERA (Shtrim në spital + Marrje e të dhënave kompjuterike)	7
TOTALI	815

1/11. 40 sec. 14030 + 140500 04 10
10 sec. 14030 + 140500 04 10
10 sec. 14030 + 140500 04 10

TABELA E MASAVE TË KËRKUARA NGA PROKURORIA DHE ATYRE TË VENDOSURA NGA GJYKATA (TABELA 6)

	Arrest në burg	Arrest në burg me afat	Arrest në shtëpi	Garanci pasurore	Detyrim për paraqitje	Pezullim nga detyra/Ndalim Dalje jashtë shtetit	Pa masë	Shtrim në spital
Prokuroria	314	3	8		91	3		6
Gjykata	223	19	22	7	140	3	1	7

TABELA E VENDIMEVE TË GJYKATËS PËR KËRKESAT PËR ÇAKTIM MASE “ARREST NË BURG” NGA PROKURORIA (TABELA 7)

	Arrest në burg	Arrest në burg me afat	Arrest në shtëpi	Garanci pasurore	Detyrim për paraqitje
Gjykata	223	19	15	6	48

TABELA E KËRKESAVE PËR ZËVËNDËSIM MASE SIGURIMI (TABELA 8)

Totali i kërkesave për zëvendësim mase	Pranuar	Rrëzuar	Pushuar	Moskompetencë
73	40	25	6	2

TABELA E LLOJEVE DHE MASAVE TË DËNIMEVE (TABELA 9)

LLOJI I VENDIMIT TË DËNIMIT	NUMRI I RASTEVE
Dënime me burg	
Dënime deri në 2 vite burgim	687
2-5 vjet burgim	55
5-10 vjet burgim	28
10-15 vjet burgim	5
15-35 vjet burgim	1
Dënime Alternative	
Burgim me kusht (Neni 59 i K.Penal)	425
Qëndrimi në shtëpi (Neni 59/a i K.Penal)	0
Punë me interes publik (Neni 63 i K.Penal)	65
Vendime të tjera	
Dënim me gjobë	70
Pushim çështjeje	37
Pafajësi	27
Mjekim i Detyruar Ambulator	8

Shënim: Në këtë tabelë përfshihen vetem llojet e dënimit për çështjet penale themeli.

TABELA E VENDIMEVE PËR DISA VEPRA PENALE MË TË HASURA (TABELA 10)

NENI	DËNIMI						
	Gjobë	Deri në 2 vjet	2-5 vjet	5-10 vjet	10-23 vjet	Burgim i përjetshëm	Pafajësi
113	7	4	0	0	0	0	0
130/a	0	39	0	0	0	0	0
134/1	1	35	0	0	0	0	1
134/2	0	55	3	0	0	0	0
134/3	0	0	0	0	0	0	0
135	0	1	0	0	0	0	0
136	0	0	1	0	0	0	0
137/2	0	5	0	0	0	0	0
139	0	0	1	3	0	0	0
143	0	8	3	0	0	0	1
143/b	0	1	0	0	0	0	0
145	1	13	0	0	0	0	0
150	2	2	0	0	0	0	0
159/1	2	8	0	0	0	0	0
170/ç	0	6	1	0	0	0	0
186	0	12	0	0	0	0	4
189	0	23	0	0	0	0	0
190	0	3	0	0	0	0	0
190/1	0	4	0	0	0	0	0
199/a1	0	65	0	0	0	0	0
199/a2	0	17	0	0	0	0	0
199/a3	0	0	1	0	0	0	0
236/2	5	6	0	0	0	0	0
237	0	4	0	0	0	0	0
248	0	4	0	0	0	0	6
278/1	0	1	7	0	0	0	0
278/2	0	2	0	1	0	0	0
279	0	6	0	0	0	0	0
283/1	0	2	17	4	0	0	0
283/2	0	1	0	9	0	0	0
290/2	0	13	0	0	0	0	0
300	0	7	0	0	0	0	0
324/a1	0	14	0	0	0	0	0
Kundërvajtje							
89	15	1	0	0	0	0	0
90	1	1	0	0	0	0	0
120	2	0	0	0	0	0	0
137/1	0	23	0	0	0	0	2
180	1	4	0	0	0	0	0
236/1	4	1	0	0	0	0	0
291	1	229	0	0	0	0	1

TABELA E SHPEJTESISE, BAZUAR NE KOHEZGJATJEN E GJYKIMIT
(TABELA NR.11)

Lloji çështjes	Deri në 2 muaj	2-6 muaj	Mbi 6 muaj	
			6 muaj-1 vit	Mbi 1 vit
Penale	658	176	17	1
Civile	2088	1326	321	

GJYQOTARI	NUMRI I ÇESHTJEVE	VITI I REGJISTRIMIT TË ÇËSHTJES
Joana Qeleshi	1 Çështje	1 Çështje viti 2012(Civile)
Rexhep Bekteshi	1 Çështje	1 Çështje viti 2018(Penale)
Paulin Çera	1 Çështje	1 Çështje viti 2018(Penale)
Fejzo Hysi	1 Çështje	1 Çështje viti 2011(Civile)
Eda Kaja	3 Çështje	3 Çështje viti 2018(Penale)
Petraç Çurri	6 Çështje	5 Çështje viti 2018(Penale) 1 Çështje viti 2018(Civile)
Markelian Koça	10 Çështje	2 Çështje viti 2015(Civile) 3 Çështje viti 2016(Civile) 2 Çështje viti 2017(Civile) 3 Çështje viti 2018(Civile)
Nurjeta Tafa	4 Çështje	1 Çështje viti 2016(Civile) 1 Çështje viti 2017(Civile) 2 Çështje viti 2018(Penale)
Shpëtim Reka	5 Çështje	1 Çështje viti 2013(Civile) 2 Çështje viti 2016(Civile) 1 Çështje viti 2017(Civile) 1 Çështje viti 2018(Civile)
Markelian Koça	10 Çështje	2 Çështje viti 2015(Civile) 3 Çështje viti 2016(Civile) 2 Çështje viti 2017(Civile) 3 Çështje viti 2018(Civile) 6 Çështje viti 2018(Civile)
Shpëtime Pitaku	6 Çështje	1 Çështje viti 2016(Civile) 1 Çështje viti 2018(Civile)
Mimoza Margjeka	2 Çështje	3 Çështje viti 2014(Civile) 1 Çështje viti 2016(Civile) 2 Çështje viti 2017(Civile) 4 Çështje viti 2014(Civile)
Vladimir Skënderi	10 Çështje	1 Çështje viti 2008(Civile) 3 Çështje viti 2014(Civile) 1 Çështje viti 2015(Civile) 1 Çështje viti 2016(Civile) 1 Çështje viti 2018(Civile)
Flora Hasimi	7 Çështje	6 Çështje viti 2018(Civile)
Besjana Garxenaj	6 Çështje	
Gjithsej	Çështje	Çështje